



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.07.2022

**MBLEDHJA Nr. 31,
Datë 13.07.2022, ora 14:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 13.07.2022, ora 14:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 31 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 07.07.2022
2. Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar ndërmjet shoqërisë Anio Oil & Gas sh.a., me të licencuarin Albpetrol sh.a., lidhur me detyrimin e instalimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, si dhe përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar, çmimit të energjisë dhe detyrimin total që shoqëria Anio Oil & Gas sh.a., ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBPETROL" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBPETROL" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALB-ENERGY" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**